BUJQESIA ORGANIKE

Drejtoria e Shërbimit Këshillimor, Shkencës e Informacionit Bujqësor

Tel/Fax+3554223269; 4223917
E-mail tana@icc-al.org
E-mail gezimxhixha@yahoo.com

BULETIN INFORMATIV
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
Nr.4 - 2007

Adresa: "Sheshi Skënderbej", Nr.2, Tiranë; Tel: + 4 232 796; Fax: + 4 227 924; www.mbumk.gov.al

1.Roli i Shërbimit Këshillimor dhe Kërkimit Bujqësor në mbështetjen e bujqësisë organike

Bujqesia organike, megjithëse në fillesat e saj, po merr një rendësi jo të vogël në zhvillimet e bujqësisë shqiptare dhe MBUMK-ja e konsideron atë si një ndër alternativat reale të prodhimit bujqësor.

MBUMK-ja gjithashtu po ploteson kuadrin institucional dhe ligjor si dhe përgatitjen e një plani masash afatmesëm për zhvillimin e bujqësisë organike në vend.

Tashmë në nivel qendror, është ngritur dhe ka filluar të funksionojë Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik, ndërsa strukturat e shërbimit këshillimor po përfshijnë gjithnjë e më tepër në programet e tyre këtë komponent.

Dy shërbimet mbështetëse si kërkimi dhe shërbimi këshillimor janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi.

Në planin e veprimit për Bujqësinë organike veç të tjerave theksohet:

- Nevoja për mbështetjen e kërkimit, arsimit dhe shërbimit këshillimor për bujqësinë organike me qëllim që të zhvillohet dhe konsolidohet një sistem njohurish kombëtare për bujqësinë organike.

Aktualisht struktura e shërbimit këshillimor publik në nivel qendror, rajonal, dhe komune, është strukturë kapilare e cila siguron kontakte të drejtpërdrejta me fermerin nëpërmjet Qendrave te Informacionit Bujqësor (QIB)

Qendrat e Informacionit Bujqësor ofrojnë**:**

Informacion për: Teknika, teknologji, inpute cilësore, legjislacion, mundësi kreditimi, marketingun, menaxhimin e fermës dhe plan bizneset, përpunimin e produkteve si dhe lehtësojnë kontaktet e fermerëve me aktoret e tjerë. (Shpërndarja e QIB-ve. Shih hartën).

Pas ristrukturimit te kërkimit bujqësor, struktura e re përfshin 5 Qendra te Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) të shperndara ne zonat kryesore agroklimatike te vendit (shih skemën)

Roli i QTTB-ve, në: Orientimin më të mire i kërkimit bujqësor ndaj,

- kërkesave te tregut ,
- prioriteteve rajonale

ne funksion te një zhvillimi te qëndrueshëm.

Detyrat e QTTB-ve, përfshijnë:

- Metoda dhe materiale (inputeve) të reja për vendin.
- Paketa teknologjike
- Kërkime dhe testime
- Hallka te larta (farash dhe fidanë).
- Trajnime, ekspertizës teknike
- Demonstrim, materiale divulgative
- Mbështetje për politik-bërësit

Çfarë ofrohet per bujqësinë organike:

-Strukture mjaft e favorshme

-Asistence e specializuar (nga bërthamat e specialisteve të DRBUMK-së dhe nga QTTB-te)

-Bashkëveprim me OJF-te dhe projekte te ndryshme

- Publikime të ndryshme

-Qendra e Bujqësisë Organike

-Bujqësia organike e përfshire si pjese e programeve te kërkimit dhe sherbimit këshillimor

Prof. Dr. Tatjana Dishnica
Drejtore e Shërbimit Këshillimor,Shkencës dhe informacionit Bujqësor
Gezim Xhixha
Përgjegjës i Sektorit të Sherbimit Këshillimor dhe Informacionit

Përmbajtja

Roli i shërbimit Këshillimor, Kërkimit në mbështetjen e bujqësisë organike	1-3
Ferma model	4
Produkte tipike	5
Pjesë nga legjislacioni shqiptar për bujqësinë	6-7
Rubrika teknike	8-9
Eksperti përgjigjet	10
Ngjarje dhe aktivitete	11
Botime për bujqësinë	12

2



Organograma e Shërbimit Këshillimor



3


SHPERNDARJA E QENDRAVE TE INFORMACIONIT BUJQESOR
VITIT 2006
SHKODER
KUKES
LEZHE
DIBER
DURRES
TIRANE
ELBASAN
FIER
BERAT
KORCE
GJIROKASTER
VLORE
120 TOTALI
3 BERAT
7 DIBER
12 DURRES
15 ELBASAN
9 FIER
8 GJIROKASTER
15 KORCE
7 KUKES
10 LEZHE
10 SHKODER
16 TIRANE
7 VLORE

4

2- Fermat model, një mjet i përshtatshëm për zgjerimin e Bujqësisë Organike

Beqir Zalli një bujk profesionist që ka filluar praktikimin e Bujqësisë organike

Kur Futesh ne fshatin Golem te komunës Rrethina, ne qendër te tij eshte edhe shtëpia e bujkut te mirënjohur Beqir Zalli . Ferma e tij ka 6 dy toke, ne te çilen ka 600 m2 sera plasmasi , 1.2 dy misër, 0.3 dy perime ,2 dy jonxhe dhe 1.9 dy livadh. E gjithë kjo ferme shtrihet ne nje terren fushor me toka aluvionale me përbërje mekanike te mesme ne te lehta.

Megjithëse Beqiri eshte 61 vjeç me shkathtësinë qe ka dhe punën e madhe qe kryen te duket si djalë i ri. Edukata përpunën dhe pasionin qe e karakterizon e ka te kultivuar nga babai i tij, Mani ,i cili ka qene një nder bujqit me te dalluar te fshatit Golem. Ketë dëshire dhe pasion Beqiri e ka kultivuar edhe tek i biri i tij, Afrimi, 31 vjeçar.

Mbetesh i befasuar kur bisedon me Beqirin dhe Afrimin për nivelin e larte te njohurive qe zotërojnë, si për teknologjitë bashkëkohore te kultivimit te perimeve ne sere si dhe për te gjitha kulturat e tjera qe kultivojnë. Ndryshe nga

fermerët e tjerë, Beqirin ne seren e tij kultivon bishtaje dhe trangull nuk njihen fare plehrat kimike vetëm ato organike. Gjate punimit te tokës dhe mbjelljes ai përdor mbi 2000 kv/ha pleh organik te kalbur mire . Me zhvillimin e bimëve krahas nevojave për ujë ai e shoqëron atë me lëng plehu për te çilen ne hyrje te seres vendos rezervuare te improvizuar te mbushur me pleh organik te freskët. Një pjesëtar i familjes e trazon atë vazhdimisht e mbas çdo ujitje me lëng plehu, sera e Beqir Zallit (mbi toka) merr ngjyre kafe ne te gjelbër sikur te ishin likene. Prodhimet e seres se Beqirit ne tregun e shumicës ne Shkodër tregtohen menjëherë te çilet tani e dine se çfarë cilësie prodhimi bie ne dorën e tyre. Rendimentet e realizuara siç e shpjegon Beqiri, me shënimet qe te lexon, si ai ashtu edhe i biri flasin me shifra dhe afate konkrete. Megjithë nivelin qe kane si fermerë këta janë te gatshëm dhe me shume dëshire te ndijojnë për sugjerimet teknike qe ju bëhen dhe marrin pjese rregullisht ne trajnimet qe organizohen ne zone për serat dhe problemet e tjera.

Pesticidet qe përdore Beqiri janë kryesisht ato qe lejon prodhimi organik si dhe përpiqet ta kufizoje numrin e trajtimeve, duke i dhëne përparmi dhe faktorëve te tjerë jo kimik, si qarkullimi bujqësor, diellzimi i seres etj. Mendojmë se ne një te ardhme te afërt ky fermerë do te certifikohet si prodhues organik e do te shërbeje si shembull për përhapjen e eksperiencës se tij edhe tek fermerët e tjerë te fshatit Golem e me gjere.

H.Gushta

5

3. Produktet tipike

Produktet tradicionale te Përmetit

Qyteti i Përmetit i shquar per një larmi produktesh tipike qe i kane rezistuar kohërave po i rikthehet edhe njëherë ripërtëritjes së tyre duke u afirmuar në tregun Shqiptar dhe atë ndërkombëtar si qyteti i glikove karakteristike, llokumeve të bajamta shuruprave dhe prevedeve të ndryshme duke ngelur si simbol i ruajtje dhe i ripërtëritjes të traditave në vite.

Produktet e traditës më tipike përmendim:

Glikotë e ndryshme si: arre, qershie, shalqini, patllixhani, kumbulle, kajsie, ftoi, fiku, agrumesh etj. Disa nga këto gliko për nga teknologjia e prodhimit, shija, dhe mënyra e servirjes janë tipike vetëm për zonën e Përmetit;

Llokumet e bajamta të ngrira me lëng trëndafili specialitet vetëm i Përmetit;

Për të ripërtërire këto produkte tipike ka vite që ka rifilluar punën dhe grupi I grave të Përmetit I quajtur: ''**ALMEG''**

Ky grup drejtohet nga Odeta Nasi dhe Eftali Qerimi.

Odeta dhe Eftalia kanë mbaruar arsimin e mesëm në vitet 80' në Shkollën teknologjike Tirane. Nga vitet 80'-90' kanë punuar si teknologe pranë ndërmarrjes Ushqimore Përmet në të cilën janë prodhuar disa nga produktet e traditës. Pas viteve 90' krijuan një grupim grash që kanë eksperience në këtë fushe dhe rifilluan

të prodhojnë disa nga produktet tipike të Përmetit.

Motivet që I shtynë në këtë biznes të vështire ishin:

Nxitja dhe zhvillimi traditës për produktet tipike që rrezikohen të humbasin ose të standardizohen;

Rritja e ofertës turistike në kuadrin e zhvillimit të agro-turizmit;

Përmirësimi i standardeve të produkteve konform parametrave evropiane;

Sensibilizimi i konsumatorëve per produktet tipike të Përmetit;

Fillimet e para të këtij aktiviteti ishin të vështira sepse tregu I brendshëm furnizohej me produkte fallso që nuk mbartnin vlerat reale të ketyre produkteve, gjithashtu kostua e lartë e prodhimit të ketyre produkteve ishte element frenues në konkurrencën e pandershme në treg.

U pa si mundësi që këto produkte të tregtoheshin ne jug të vendit pasi dhe informacioni ishte me I plotë në këto qytete. Për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve duhej patjetër që të standardizohej një prodhim artizanal larg prodhimit fallso apo industrial.

Në këto kushte zgjidhja e vetme ka qenë rritja e treguesve cilësore të prodhimit duke prodhuar prodhime artizanale sipas parametrave të amvisave të vjetra të Përmetit.

Qysh në hapat e para u zbatuan dhe u ndoqën eksperiencat e amvisave të vjetra më të cilat u bashkëpunua në elemente specifike si aroma, shija, ekspozimi, etj.

U nis duke prodhuar 2000 vazo glikosh të ndryshme në vitin e parë për të arritur sot në 15000 vazosh me një llojshmëri frutash të përpunuara.

V.Nikolla

6

4.Legjislacioni për bujqësinë organike në Shqipëri

PJESË NGA L I G J I Nr.9199, datë 26.2.2004 PËR PRODHIMIN, PËRPUNIMIN, CERTIFIKIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE "BIO"

Neni 10

Referimi i metodave të prodhimit

1. Etiketa dhe reklama e një produkti do t'u referohen metodave të prodhimit organik vetëm kur:

a) tregues të tillë dëshmojnë qartë se janë të lidhur me një metodë të prodhimit organik;

b) produkti është prodhuar dhe tregtuar në përputhje me rregullat e dhëna në këtë ligj;

c) produkti nuk ka qenë subjekt i trajtimeve, duke përfshirë përdorimin e rrezatimit të jonizuar;

ç) produkti nuk është gjenetikisht i modifikuar.

2. Etiketa dhe reklama e një produkti, të përbërë nga shumë përbërës dhe të përpunuar, u referohen metodave të prodhimit organik vetëm kur:

a) 95 për qind e masës së përbërësve me origjinë bujqësore (bimore dhe blegtorale) të produktit janë ose rrjedhin nga produkte të prodhuara dhe të tregtuara në përputhje me rregullat e dhëna në këtë ligj, ndërsa diferenca 5 për qind nuk sjell ndikim në standardin e produktit. Baza e llogaritjes është pesha e plotë përpara përpunimit dhe jo produkti përfundimtar;

b) produkti përbëhet vetëm nga substancat e listuara në seksionin "A" të aneksit VI, si përbërës me origjinë jobujqësore dhe gjatë përpunimit të tij janë përdorur vetëm substanca të listuara në seksionin "B" të aneksit VI, kur justifikohet që pa këto produkte ai nuk mund të prodhohej;

c) produkti përmban si përbërës me origjinë bujqësore joorganike vetëm substancat e listuara në seksionin "C" të aneksit VI;

ç) produkti ose përbërësit e tij nuk u janë nënshtruar trajtimeve, duke përfshirë përdorimin e rrezatimit të jonizuar gjatë përpunimit (duke përfshirë përpunimin e përbërësve);

d) produkti nuk përmban OGJM ose produkte që rrjedhin nga prodhimi i këtij tipi.

Neni 11

Etiketa dhe reklama e produkteve me shumë përbërës

Etiketa dhe reklama e një produkti me shumë përbërës, i përgatitur nga përbërës që pjesërisht nuk plotësojnë kërkesat e shkronjës "a" pika 2 të nenit 10 të këtij ligji, mund t'u referohen metodave të prodhimit organik me kusht që:

a) të paktën 70 për qind e përbërësve me origjinë bujqësore plotësojnë kërkesat e dhëna në shkronjën "a" pika 2 të nenit 10;

b) produkti plotëson kërkesat e dhëna në shkronjat "a" dhe "d" pika 2 të nenit 10 dhe pjesa e mbetur e përbërësve nuk është në sasinë dhe cilësinë e duhur;

c) treguesit që u referohen metodave të prodhimit organik, u referohen, qartësisht, vetëm përbërësve me origjinë bujqësore, organike;

ç) përbërësit dhe nivelet relative të tyre vendosen në listën e përbërësve në rendin zbritës në peshë;

d) treguesit në listën e përbërësve shkruhen me shkronja të njëjta, me ngjyrë, madhësi dhe mënyrë të njëjtë;

dh) për referencat e përmendura më lart mund të përdoret treguesi "X për qind" i përbërësve me origjinë bujqësore, që janë prodhuar në përputhje me rregullat e metodave të prodhimit organik.

Neni 12

Etiketa e produktit në konvertim

1. Në etiketën e produktit tregimi i konvertimit në prodhimin organik mund të përdoret nëse produkti përmban vetëm një përbërës me origjinë bujqësore dhe:

a) plotëson të gjitha kërkesat, me përjashtim të periudhës së konvertimit dhënë në aneksin I;

b) periudha e konvertimit është jo më pak se 12 muaj përpara hedhjes së tij në treg;

c) etiketa e produktit në konvertim duhet të dallohet prej konsumatorit nga produkti "Bio", i cili plotëson kërkesat e këtij ligji;

ç) trupi inspektues inspekton dhe verifikon plotësimin e kërkesave të shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni.

2. Në etiketën e këtij produkti duhet të KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 16

1. Në qoftë se fara ose materiali tjetër riprodhues nuk plotëson kërkesat e këtij ligji, duhet të përdoret vetëm me miratimin e organizmit certifikues.

2. Materialet e paketimit, të prodhuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në përputhje me kërkesat e tij, mund të përdoren deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Kërkesat e këtij ligji, në mbështetje të Rregullores së Bashkimit Europian nr.2092/91, datë 24.6.1991 "Në prodhimin organik të produkteve bujqësore dhe treguesit që i referohen produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore", përbëjnë kërkesat minimale për zbatim në sistemin e prodhimit "Bio".

përdoret emërtimi "Produkt në proces konvertimi", i cili duhet të dallohet në stil ose ngjyrë nga shënimet e tjera në etiketë. Në tekst termi "Bio" nuk duhet të mbindriçohet.

KREU VI

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 13

Në kuptim të këtij ligji, shkeljet që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative si më poshtë:

a) moszbatimi i rregullave të prodhimit bimor, shtazor, në nivel ferme (Aneksi I shkronjat "A", "B" dhe "C");

b) moszbatimi i rregullave të plehërimit, pasuruesve të tokës dhe pesticideve (Aneksi II);

c) moszbatimi i rregullave të magazinimit (Aneksi III);

ç) moszbatimi i rregullave të tregtimit të produkteve "Bio" (Aneksi III);

d) mosrespektimi i normave maksimale të kafshëve për një ha/tokë për prodhimin e plehut organik, i njëvlefshëm me 170 kg N/ha vit (Aneksi VII);

dh) mosrespektimi i normave të sipërfaqeve normale për mbajtjen e specieve të ndryshme të kafshëve (Aneksi VIII);

e) mosrespektimi i rregullave të inspektim-certifikimit, të parashikuara në këtë ligj.

Neni 14

Sanksionet

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, ndërmerren sanksionet e mëposhtme:

1. Organizmi certifikues, për shkeljet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, "d" dhe “dh”, merr masat e mëposhtme:

a) analizë shtesë;

b) inspektim shtesë;

c) rikthim (ulje) të fazës së certifikimit, pas rezultateve të analizës dhe të inspektimit shtesë;

ç) zhvlerësim të produktit ose pjesës së mallit pas analizës dhe inspektimit shtesë;

d) pezullim të certifikimit dhe në rast përsëritjeje, ndërprerje të kontratës së bashkëpunimit.

2. KSHPO-ja merr masat e mëposhtme:

a) për shkeljet e parashikuara në shkronjën “c”, zhvlerësim të produktit (mallit) ose pjesës së mallit;

b) për shkeljet e parashikuara në shkronjën “ç”, bllokim të mallit dhe analizë të mostrës së tij dhe në rast shkeljeje, gjobë në masën 50 mijë deri në 100 mijë lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në shkronjën “e”, pezullim të certifikimit dhe në rast përsëritjeje, zgjidhje të kontratës së bashkëpunimit.

Neni 15

Procedurat e kundërvajtjes administrative

1. KSHPO-ja dhe organizmi certifikues kanë të drejtë të vendosin masa administrative të përcaktuara në nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.

2. Mënyra e vjeljes së gjobës dhe shpërndarja e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

3. Kundër vendimit të masës së dhënë mund të bëhet ankim me shkrim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, te Kryetari i KSHPO-së, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

2. Në etiketën e këtij produkti duhet të KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 16

1. Në qoftë se fara ose materiali tjetër riprodhues nuk plotëson kërkesat e këtij ligji, duhet të përdoret vetëm me miratimin e organizmit certifikues.

2. Materialet e paketimit, të prodhuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë në përputhje me kërkesat e tij, mund të përdoren deri në 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Kërkesat e këtij ligji, në mbështetje të Rregullores së Bashkimit Europian nr.2092/91, datë 24.6.1991 "Në prodhimin organik të produkteve bujqësore dhe treguesit që i referohen produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore", përbëjnë kërkesat minimale për zbatim në sistemin e prodhimit "Bio".

Neni 18

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 3, 4 dhe 15 të këtij ligji.

5. RUBRIKA TEKNIKE

Molla — skema e mbrojtjes bimëve në bujqësinë organike

Fazat	Paraziti	Lënda aktive	Preparati	Dozat	Shenime
Parafryrja e sythave	Breshkëza e Kalifornisë	Vaj parafine	UFO o ULTRA CITRUS	1000-2000 cm³/hl	Trajtim bazë sidomos në rastin e
Nga veshët e miut – gonxhet lulore ngjyre rozë	Kroma (nëse nuk kultivohen kultivarë rezistentë)	Kripërat e bakrit	-	Dozat në etiketë	Të kryhen të paktën 2-3 trajtime në këtë fazë, por brënda 1 ditë nga fillimi i shiut
	Morri i përhimtë	Azadiractina	NEEM AZAL*	3 l/ha	Trajtim i domosdoshëm
Lulëzim	Kroma	Zolfo WG	-	-	Veprohet 1 ditë para shiut ose para shiut në bazë te parashikimeve
		Proteinat e Squfurit	-	700 gr/hl	
Nga rënia e petulave deri- në madhësinë e frutit sa një arrë	Morrat	Piretro natyral +	BIOPIREN PLUS o PIRESAN	150 o 80 cm³ +	Ndërhyhet kryesisht me shfaqjen e infeksioneve të para.
		Vaj parafine	UFO o ULTRA CITRUS	1000 gr/hl	
	Kroma	Kripërat e bakrit	-	Dozat në etiketë	Shiko shënimet më lart
		Squfur WG	-	-	
		Proteinat e squfurit	-	Dozat në etiketë	
	Hiri	Squfur WG	-	-	
		A.quisqualis+	AQ10** +	70 gr/ha +	Ndërhyrje të hershme
		Vaj pishe	VAPOR GARD	30 cm3/hl	
	Virusi i granuluar	MADEX+	100 cm3/ha +	Vendosen grackat	Vendosen grackat hormonale. Eshte e rëndësishme të shtojmë sheqer ose melasë
	+ Vaj pishe	VAPOR GARD+	300 cm3/ha+	Vendosen grackat	
	+ Melasë	BORLAN	500 cm3	Vendosen grackat	
	Krimi degëve/ krimbi i trungut	Gracka për kapje masive	MAXI ZEUCO	6-10 gracka/ha	Vendosen grackat 30-50 cm mbi kurorën e pemës.
Nga fruti në madhësinë e një arre deri në vjelje	Kroma	Squfur WG	-	-	Shiko shënimet më lart
		Proteinat e squfurit	-	700 gr/hl	
	Krimbi i mollës	Virusi i granuluar	MADEX +	100 ml/ha +	Periudhat e mbulimit 8 ditë
		+ Vaj pishe	VAPOR GARD +	300 cm3/ha +	
		+ Melasë	BORLAN	500 cm3/hl	
		Konfuzione seksuale	-	-	Metoda eshte më efikase ndaj breznisë II e III në sipërfaqe të rregullta më shumë se 1 ha deri në nivel mesatarë infeksioni.
	Morrat	Piretro natyral +	BIOPIREN PLUS o PIRESAN	150 o 80 cm³ +	
		Vaj parafine	UFO o ULTRA CITRUS	1000 gr/hl	
	Breshkëzat	Vaj parafine	UFO o ULTRA CITRUS	1000/1500 cm3/hl	Në çeljen e (neanideve) larvave të rritura.
	Flutura tortricide (ngrënësit e gjetheve)	Bacillus thuringiensis (ceppo EG2348)	RAPAX	100-150 cm3/ha	Nëse janë të pranishme kryhen së paku 2 trajtime sipas sipas kapjeve duke përdorur Delta Trap Intrachem
	Tingide (çimkat) Corythucha ciliata	Piretro natyral+	BIOPIREN PLUS o PIRESAN	150 o 80 cm3 +	Përsëritet pas 8-10 ditësh; trajtimi eshte më efikas ndaj stadeve të reja. Përsëritet 2-3 herë.
		Vaj parafine (Beauveria bassiana)	UFO o ULTRA CITRUS NATYRALIS **	1000 gr/hl 150 cm3/ha	
	Këpusha e kuqe	Vaj parafine	UFO o ULTRA CITRUS	1000 cm3/hl	-
	Krimbi i degëve	Bacillus thuringiensis	RAPAX	100-150cm3/hl	Nëse nuk përdoren kapje masive
Rënia e gjetheve	Kanceri i degëve	Lëngu bordolez		1000cm3/ha	

9

5. RUBRIKA TEKNIKE– VAZHDON

Molla organike: nderhyrjet agronomike

Fazat Fenologjike	Veprimi	Lenda aktive	Produkti	Dozat	SHënime
Fundi i dimrit	Plehërim organik	Përmirësues organik Pleh organik NP	VEGAMM PROGIDI	1000-1200 kg/ha	Përdoret Nuk përdoret
Veshët e miut	Përdorim gjethor	Auxine, Gibberelline e Citochinine natyrale	PHYTAGRO	1 l/ha	Kryesisht në rastet e stresit klimatik temperaturave të ulëta, ndriçim i dobët)
Para lulëzimit	Përdorim gjethor	Aminoacidi, Boro e Alghe	LYSODINE CALCIUM-	1000-2000 gr/ha	
Lidhja e frutave	Përdorim gjethor	Aminoacidi,	LYSODINE CALCIUM-	2kg +	Kundër qelqëzimit
		Calcium e Alghe +	EXPRESS +		
		Faktorë e rritjes	BF 400	1 kg/ha	Rritja e madhësisë së frutit
Nga frutat arrë në vjelje	Përdorim gjethor	Aminoacidi,	LYSODINE CALCIUM-	2kg +	Ndërhyhet me LYSODINE CALCIUM EXPRESS çdo 10-15 ditë kundra qelqëzimit. Shtohet BF 400 pas 20 dite nga trajtimi i parë
		Calcium e Alghe +	EXPRESS +	1 kg/ha	
		Faktorë e rritjes	BF 400		

10

6. EKSPERTI PERGJIGJET:

1.Cilat janë masat për mbrojtjen e pemëve frutore gjate muajve Janar-Shkurt-Mars

Kultivuesit e pemëtoreve vëmendjen kryesore gjatë kësaj periudhe duhet ta drejtojnë në marrjen e disa masave për minimizimin e rezervave dimërore të sëmundjeve e dëmtuesve.

JANAR

Vazhdojnë shërbimet me rendësi fitosanitare si punimet me anën e te cilave përmbysen mbeturinat bimore me rezerve infektuese, nëpërmjet krasitjeve hiqen degët e prekura nga sëmundjet si: **kroma, zjarri bakterial** etj. si dhe ato te prekura rende nga **breshkëzat, kalbëzimet** e frutave etj.

Përgjithësisht, higjienizimi i pemëtoreve eshte një mase me shume per te kufizuar popullatat e parazitëve ne pemëtari. Eshte koha kur kryhen trajtimet kimike dimërore. Trajtime te tilla, mund te kryhen me **Lëng bordolez 1%** dhe **me vajra minerale** qe janë te efektshëm ne luftimin e breshkëzave. Sidomos ne bimën e pjeshkës, një trajtim me Lëng bordolez nuk duhet nënvleftësuar. Ky trajtim eshte shume i efektshëm ndaj sëmundjes se gjethepërdredhëses qe eshte e pranishme çdo vit ne pjeshke.

Ne janar bëhen edhe shërbime të tjera si kullimi i pemëtoreve, plehërimi i tyre, **gëlqerimi i trungjeve** qe ne fund te fundit kane gjithashtu vlera fitosanitare, sepse ndihmojnë per një zhvillim te shëndetshëm te pemëve; sidomos ne peme te tilla si: qershia, kajsia. **Kullimi dimëror eshte i domosdoshëm,** sepse këto specie pemësh nen praninë e lagështirës se tepërt preken nga shume sëmundje qe i çojnë ato deri ne tharje. Gjate janarit vazhdon puna per sigurimin e mbjelljen e fidanëve per mbjelljet e reja.

Behet kujdes qe fidanët te jene te pasteta nga sëmundje te tilla si: **kanceri i rrënjëve, zjarri bakterial etj. si dhe te pastërta nga breshkëzat e këpushat (kontrollohen lastarët nëse kane veze te këpushës se kuqe dhe per vezët e afideve). Fidanët qe nuk plotësojnë parametrat Fitosanitar, te mos mbillen!**

SHKURT

Vazhdojnë po ato procese pune me karakter agroteknik dhe Fitosanitar qe u përshkruan per muajin janar. Vazhdon kontrolli Fitosanitar i fidanëve qe do te mbillen.

Mars

Ne zonën bregdetare dardha eshte ne lulëzim te plote (ne dhjetëditorin e tretë) - Dëmtuesi i pare dhe kryesorë që aktivizohet ne dardhe eshte grerëza e dardhës. Gjate lulëzimit, grerëzat e rritura dalin nga pupat dhe afrohen ne kurorën e dardhës. Grerëzat tërhiqen nga sfondi i bardhe i luleve. Kete instinkt, insekti e ka fituar me shekuj.Per kete fakt, gjurmimi i insekteve te rritur ne pemëtore, realizohet me gracka te ndërtuara nga tabela te bardha me ngjitës special. Përmasat e tabelave grackëkapëse janë 25x20cm.

Kumbulla: Në gjysmën e pare te muajit, per zonën bregdetare fillon lulëzim. Ne fund te muajit, lulëzimi ka përfunduar. Ne kete faze dëmtues, kryesor dhe gati i përvitshëm eshte grerëza e kumbullës (Hoplocampa minuta). Ky dëmtues gjate muajit mars ka dale nga pupëzimi, dhe vendos vezët ne kupën e lules. Ashtu si grerëza e dardhës edhe grerëza e kumbullës tërhiqet nga ngjyra e bardhe. Teknika e monitorimit eshte njëjte me atë te grerëzës se dardhës. Larvat çelin ne kohen e lidhjes se futit, kur futi ka madhësinë e kokrrës se grurit tashme larva eshte brenda, ndërsa kur fruti ka madhësinë e bërthamës se ullirit, larva gati ka mbaruar zhvillimin e saj. Studimet e bëra ne vendin tone (E. Isufi 1991), reguan se koha më e përshtatshme e luftimit per kultivarët qe lulëzojnë herët është kur kane rene 85 e petaleve, pra kur kumbulla sapo ka lidhur frutin. Studimi gjithashtu tregoi se kur trajtimi vonohet 8-12 dite më vone, humbjet në prodhimin e kumbullës kaluan mbi 30%. Preparatet me baze Dimethoat (Rogor, Aragol etj.), janë formulime shumë të efektshme kundër grerëzës. Këtë muaj shpesh mund të kemi shtim të afideve, por duhet te kufizohemi ne luftim kimik te tyre sepse parazitët natyral e frenojnë popullatën e acideve. Trajtime mundë kryhen vetëm nëse infeksioni ka prekur pemët e reja.

Pjeshka: është në lulëzim dhe çeljen e gjetheve (zona bregdetare) Ne këtë faze mundësia me e madhe eshte që të shfaqen afidet por kjo në vite me klime të ngrohte. Nëse është nën vlehtësuar trajtimi dimëror me lëng bordolez, gjethet do të preken nga gjethepërdredhësja.

Për të gjitha këto konsultohuni me Specialistët e Shërbimit Këshillimor, dhe ofrues të tjerë të këtij shërbimi.

E.Isufi

7. Ngjarje dhe aktivitete

Krijohet Bio-Coop Divjaka

Janar 2007 perbën një ngjarje për lëvizjen e Bujqësisë Organike në Shqipëri. Krijohet e para Kooperativë me profil bujqësor tregtar për prodhimet organike në Shqipëri. Kjo është një risi që tregon se lëvizja e bujqësisë organike kërkon hapsira të reja për të shpalosur përparësitë e saj, për të hyrë në mënyrë dinjitoze në tregun lokal të prodhimeve bio si dhe për të çelur pistat për eksport të këtyre produktve. Vetë krijimi i kooperativës përbën risi në vetvete. Pak janë të tilla të regjistruara në vend dhe shumë më pak janë funksionale. Bio-Coop Divjaka gërsheton në mënyrë të përkryer të dy elementët që i duhen sot bujqësisë Shqiptare, kooperativën dhe produktin "Bio".

Element tjetër i rëndësishëm në këtë ngjrje është fakti se ky organizim vjen nga Divjaka, që padyshim është promotor në bujqësinë shqiptare. Ekosistemi i saj si rrallë në vend tjetër prodhon në mënyrë gjithëvjetore perime të freskëta.

Por jo vetëm natyra është bujare në Divjakë. Vetë banorët e saj janë mjaftë puntorë e të apasionuar për prodhimin bujqësor. Nuk mun të mos përmendet si një vlerë e rrallë Divjaka edhe për lagunën e Karavastas, e cila është e përfshirë në Konventën Ramsar, për madhësinë e pasurinë e jashtëzakonshme të biodiversitit të saj.

Por kur flasim për një organizim shoqëror nuk mund të mos përmendet roli i organizatorit të saj kryesor. Dhe Bio-Coop Divjaka ka një emër që identifikohet, dhe që është drejtuesi e krijuesi i saj, që quhet Anastas Prifti. Caci i thonë në Divjak, nuk gjen plak e fëmijë qe nuk e njeh Cacin. Anastasi është i kujdeshëm në hapat që hedh. Ai mendon se fillimi duhet të jetë i kujdeshëm, prandaj Kooperativa shënon si fillim numrin 8 persona. Por ajo do rritet shpejt.

Një projekt suedez, nën drejtimin e organizatës KF Centër dhe Shoqatës së Bujqësisë Organike ka dhënë një kontribut modest në krijimin e kësaj kooperative. Por Kooperativat në Shqipëri janë si fëmijët në pelena. Shteti duhet të kujdeset për to. Ato do t'ja shpërblejnë shtetit shpejt këtë kujdes.

Suksese për Bio-Coop Divjaka.

Lavdosh Ferruni

Propozim per organizimin e një shërbimi te specializua ne menaxhimin dhe zhvillimin e Bujqësisë organike ne Shqipëri

Me datë 10.01. 2007 u organizua një tavolinë e rrumbullakët me pjesëmarrjen e drejtuesve të projektit PAB, Drejtorive Teknike, strukturave të shërbimit këshillimor, shoqatave të bujqësisë organike, u diskutua "Propozimi per organizimin e një shërbimi te specializua ne menaxhimin dhe zhvillimin e Bujqësisë organike ne Shqipëri.

Ky dokument eshte një propozim strategjik per specializimin e shërbimeve këshillimore ne Shqipëri me qellim qe ti jepen kompetenca dhe burime per mbështetjen e zhvillimit te bujqësisë organike ne Vend.

Ky propozim hyn ne një strategji komplekse drejtuar jo vetëm përmirësimit te kompetencave te shërbimeve këshillimore ne fushën e informatizimit dhe te përhapjes, por mbi te gjitha pajisjen e sistemit te bujqësisë organike me një zyre te specializuar si referimin institucional ne mbështetje te zhvillimit te sektorit dhe zbatimin e normativave kombëtare.

Përcaktimi i një strukture te tille operative eshte një kërkese e nevojshme per ti dhëne kuptim përpjekjeve te bëra nga institucionet shqiptare per një administrim efikas te sektorit te bujqësisë organike, dhe do ti jepte një mundësi vazhdimësie ndërhyrjeve te bëra nga projekti PAB dhe nga projektet e tjera te bashkëpunimit ne vend.

8. Botime per bujqesine organike

Një bibliotekë e pasur pranë Drejtorisë së Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Informacionit Bujqësorë në MBUMK-në, (Projekti PAB)

Kjo qendër funksionon dhe mbështetet nga *"Projekti i integruar për përhapjen dhe asistencën teknike në zbatimin e metodave të prodhimit*

organik (PAB)". Qendra shërben si një pikë fokale per koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve që po kryhen në kuadrin e projektit. Ajo gjithashtu po luan një rol të rëndësishëm për krijimin e një rrjeti informativ për bujqësinë biologjike (organike); do të ofrojë asistencë teknike (përfshirë edhe atë *on-line)* si dhe informacion për të ndihmuar vendim-marrjen në ferma, nëpërmjet një programi të posaçëm kompjuterik.

Në kuadër të zgjerimit të saj janë të mirëpritur libra nga autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj.

Pranë qendrës mund të konsultohen edhe artikuj të ndryshëm të 13 periodikëve ndër më të njohurit e bujqësisë, Shërbimit Këshillimor dhe Bujqësisë bio, si: ***Informatorio Agrario,***
Informatorio Fitopatologico,
Frutticoltura, Colture protette, The Journal of Agricultural Education and Extension, AZ Bio, BioActualité,
Terra e Vita,
Ecology and Farming, Medit, etj.

Këto botime dhe artikuj janë kataloguar në polin italian SEBINA (www.sinab.it)
(Sistemi kombëtar italian i informacionit mbi bujqësinë biologjike). Midis bibliotekave që bëjnë pjesë në këtë pol, mund të shkëmbehen materiale dhe artikuj nëpërmjet fax, etj. Pranë zyrës së projektit PAB, mund të konsultohen dhe fotokopjohen materiale të ndryshme për të gjithë të interesuarit.

Hyrje të reja pranë bibliotekës PAB

Alimentazione della vacca da latte i Vittorio Dell'Orto dhe Giovanni Savoini. Ky libër paraqet aspekte të të ushqyerit të lopëve për qumësht, për marrjen e qumështit me standard të lartë cilësie. Botuar nga Edagricole, ka 268 faqe.

Orticoltura specializzata e Luciano Trentini dhe Giorgio Sitta. Libri përshkruan kultivimin e mbrojtur të perimeve, në veçanti për kulturat asparagus, pjepër, domate dhe kungull. Botim i vitit 2001.

Manuale di frutticoltura i Carlo Edoardo Branzanti dhe Angelo Ricci. Manuali jep një panoramë të plotë të fazave dhe periudhave të pemëve frutore, zgjedhja e ambientit dhe distancat e mbjelljes së kulturave të ndryshme, llojet kryesore të krasitjes dhe në veçanti për farorët, bërthamorët, kivin, menaxhimin e pjellorisë së tokës, etj. Botim i Edagricole, 2001, ka marrë vlerësime pozitive nga shumë kritikë si Giorgio Bargioni, etj.

Lotta biologica i M. Ferrari, E. Marcon dhe A. Menta. Libri përshkruan agroekosistemin në tërësi, menaxhimin e integruar të dëmtuesve, dhe menaxhimin biologjik me anë të predatorëve, parazitëve, mikroorganizmave dhe aktorëve të tjerë që ndihmojnë në uljen e popullatave të dëmtuesve. Botim i vitit 2000, ka 355 faqe.

Progetto finanziato dal Fondo Europeo di Sviluppo Regionale

http://pab.iamb.it

Drejtoria e Shërbimit Këshillimor,
Shkencës e Informacionit Bujqësor

Tel:+3554223269; 4223917
E-mail tana@icc-al.org
E-mail gezimxhixha@yahoo.com

Istituto Agronomico
Mediterraneo di Bari

Tel. +39/080/4606304
Fax +39/080/4606268
E-mail pab@iamb.it